





**Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë**

Rr. e Kavajës, Nr.6, Tiranë  
Tel.+355-4-230284/232446  
Fax.+355-4-227997/23244  
E-mail: [ccitr@abissnet.com.al](mailto:ccitr@abissnet.com.al)  
<http://www.cci.gov.al>



Rr."Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pall.1  
P.O.BOX 7476, Tirana-ALBANIA  
Tel/Fax: +355 4 25 48 20  
E-mail: [info@alb-ppfi.org](mailto:info@alb-ppfi.org)  
<http://www.alb-ppfi.org>

# Udhëzues për Bizneset mbi Proçedurat Anti-Dumping

Ky material është përgatitur nga Instituti i Financave Publike dhe Private në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë. Kjo Guidë mbështetet në dokumentat bazë të Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO) dhe Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë (ITC) dhe studime të organizatave të tjera ndërkombëtare.

*Tetor 2002*

---

## Përmbledhje

Sot, veprimet anti-dumping përfaqësojnë një pjesë të madhe të masave të lehtësimit të importit të ndërmarra nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Megjithatë është e cuditshme që palëve kryesore të përfshira në procedurat anti-dumping-eksportuesve, importuesve dhe prodhuesve vendas të produktit në fjalëshpesh u mungojnë njohuritë se çfarë përfshihet në këto veprime. Efektet e kësaj mungese njohurish janë në shumicën e rasteve, pozicione të dobëta në procedura dhe humbje të konsiderueshme financiare.

Kohët e fundit, shumë vende në zhvillim-shënjestrat kryesore të veprimeve anti-dumping- kanë filluar të zbatojnë vetë të tilla procedura me një ritëm të përshpejtuar nderkohë që kanë liberalizuar regjimet e tyre të importit. Në mënyrë ironike, shënjestrat në të shumtën e rasteve janë vende të tjera në zhvillim. Arsyet për këtë kryesisht janë ngjashmëritë në strukturën e industrive në vendet në zhvillim, dhe pjesërisht praktikat agresive në vendosjen e cmimeve të eksporteve të disa eksportuesve nga vendet në zhvillim, gjë e cila mund të jetë një pasqyrim i nevojave të mëdha të këtyre vendeve për valutë.

Për këtë arsye, për importuesit e eksportuesit e vendeve në zhvillim informacioni për veprimet anti-dumping është shumë më i rëndësishëm sot sesa në të kaluarën. Megjithatë të dish më tepër rreth këtyre veprimeve nuk do të thotë të jesh subjekt i tyre më rrallë; eksportuesit dhe importuesit e vendeve në zhvillim mund të ulin dëmin e mundshëm që këto veprime mund t'u shkaktojnë atyre duke siguruar që ato marrin informacionin që kërkojnë dhe marrin pjesë sa më shumë të jëtë e mundur në hetimet në të cilat ato bëhen pjesë.

Kjo guidë, e përgatitur nga Instituti i Financave Publike dhe Private (PPFI) në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, është dizenuar për të ofruar informacion praktik rreth veprimeve anti-dumping për bizneset shqiptare qofshin keto aktivitete tregtare (eksport/import) ose prodhuese.

## Përmbajtja

	Faqe
1. Hyrje.....	3
2. Koncepte të përgjithshme.....	5
2.1 Masat Anti-Dumping.....	5
2.2 Dumping.....	5
2.3 Dëmtim dhe Kërcënimi për Dëmtim.....	8
3. Hetimet Anti-Dumping.....	11
3.1 Fillimi i një Hetimi Anti-Dumping.....	11
3.2 Procedura e Hetimit.....	12
3.3 Zbatimi i Masave Anti-Dumping.....	15
4. Veprimet që pasojnë Mbylljen e Hetimeve Anti-Dumping.....	22

## 1. Hyrje

Kjo guidë është e përbërë nga tre seksione, cdonjëra prej të cilave përmban informacion lidhur me anti-dumping për eksportuesit dhe importuesit:

- Koncepte të përgjithshme
- Hetimet anti-dumping
- Përtej mbylljes së hetimeve anti-dumping

Në seksionin e parë, shpjegohen konceptet e “masave anti-dumping”, “dumping”, “dëmtim”, “kërcënimi për dëmtim”. Seksioni i dytë fokusohet në hetimet anti-dumping, duke theksuar fillimin dhe procedurat e hetimeve anti-dumping dhe zbatimin e masave anti-dumping. Seksioni i fundit u drejtohet çështjeve që lidhen me pikëpamjen administrative dhe juridike të masave anti-dumping si edhe konsultimet ndërqeveritare dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbi veprimet anti-dumping.

Disa nga pyetjet e mundshme të importuesve dhe të eksportuesve të cilave u është dhënë përgjigje në seksionet e ndryshme të kësaj guide përfshijnë të mëposhtmet:

- **Koncepte të përgjithshme**

- Cfarë është dumping? (A jam duke eksportuar/importuar një produkt dumped?)
- Cfarë është dëmtimi (dhe kërcënimi për dëmtim)? (Eksportet/importet e mia a shkaktojnë apo kërcënojnë për dëmtim prodhuesit vendas?)
- Cfarë është një masë anti-dumping
- Nën cilat kushte zbatohet një masë anti-dumping?
- A mund të zbatohen masat anti-dumping në të gjitha vendet?

- **Hetimet anti-dumping**

- Si fillohen veprimet anti-dumping?
- Cila është procedura që ndiqet në rastin e një hetimi anti-dumping?
- Sa zgjat një hetim anti-dumping?
- Fillimi i një hetimi anti-dumping a do të thotë që unë nuk mund të importoj/eksportoja produktin?

- 
- A duhet të bashkëpunoj me autoritetet? Cfarë ndodh nëse nuk bashkëpunoj?
  - Si do të trajtohet informacioni im konfidencial gjatë një hetimi?
  - Cilat janë të drejtat e mia në kuadrin e një hetimi anti-dumping?
  - Cfarë informacioni mund të kërkoj unë që të mos paraqitet nga autoritetet?
  - A mundet unë të influencoj rezultatin e një hetimi anti-dumping? Si?
  - A mund të kërkoj një seancë dëgjimi nga autoritetet?
  - Cfarë është një masë e përkohshme? Cfarë forme mund të marrë ajo? A mund të më kthehen detyrimet e përkohshme që kam paguar?
  - Cfarë është një detyrim përfundimtar anti-dumping?
  - A mundet që detyrimet anti-dumping të kenë forcë prapavepruese mbi importet/eksportet e realizuara përpara fillimit të hetimit anti-dumping (d.m.th. përpara vendosjes së detyrimeve të përkohshme)?
  - Cfarë është një sipërmarrje në cmim? Kush e realizon atë? Cilat janë përfitimet për mua?
  - Nëse filloj të importoj ose eksportoj pas zbatimit të detyrimeve anti-dumping mbi importuesit/eksportuesit e vendit eksportues, a do të zbatohen detyrimet anti-dumping mbi importet apo eksportet e mia?
- **Veprimet që pasojnë mbylljen e hetimeve anti-dumping**
    - Për sa kohë duhet të paguaj detyrimin anti-dumping?
    - Si dhe kur mund të kërkoj që detyrimi anti-dumping të përfundojë (ose të rishikohet)?
    - A mund ta çoj problemin tim në gjyq?
    - A ekziston ndonjë forum ndërkombëtar për diskutimin e detyrimeve anti-dumping? Cfarë niveli të fuqisë shtrënguese ka mbi autoritetet e një vendi të dhënë?

## 2. Konceptet e pergjithshme

### 2.1 Masat Anti-Dumping

Rregullat e Organizates Botërore të Tregtisë (OBT) i lejojnë vendeve anëtare të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur industrinë e tyre vendase nga praktikat “e ndershme” të tregtisë nga eksportuesit e huaj. Dumpingu i eksporteve konsiderohet si një nga praktikat e pandershme të tregtisë.

Nëse, pas realizimit të një hetimi anti-dumping, një vend importues përcakton që:

- (a) importet e një produkti kanë qenë “dumped” dhe
- (b) këto importe shkaktojnë ose kërcënojnë “dëmtim” për prodhuesit vendas të “atij produkti<sup>1</sup>” ose materialisht vonojnë vendosjen e një industrie vendase,

atëherë ai mund të zbatojë një masë anti-dumping në formën e “një take doganore anti-dumping” ose “të sipërmarrjes në cmim” mbi importet në fjalë.

Sipas kësaj mënyre, përcaktimi i “dumping” nuk është i mjaftueshëm për të vendosur taksa doganore anti-dumping. Në fakt çfarë është gjithashtu e nevojshme-dhe e cila aktualisht nis të gjitha procedurat anti-dumping-është dëmtimi që vuan industria vendase.

### 2.2. Dumping

Është e pamundur të përcaktosh nëse një e mirë është dumped, thjesht duke ditur cmimin e saj të eksportit; një produkt, p.sh. mund të jetë i lirë, por “jo dumped”, ose mund të jetë i shtrenjtë dhe të jetë “dumped”. Në fakt, dumping është relativ; është çështje krahasimi. Një krahasim duhet të bëhet midis cmimit të eksportit të produktit dhe “vlerës normale” (zakonisht cmimi në tregun vendas) të atij produkti në vendin eksportues. Në qoftë se cmimi i eksportit është më i ulët se vlera normale, atëherë produkti konsiderohet të jetë dumped. Diferenca midis tyre është “marzhi dumping”.

---

<sup>1</sup> Një produkt identik me atë të importuar, ose në mungesën e një produkti të tillë, një produkt tjetër që ka karakteristika shumë të ngjashme me ato të produktit në fjalë.

Cmimi në tregun vendas të vendit eksportues mund të mos zgjidhet për këtë krahasim kur :

- (a) volumi i shitjeve vendase në vendin eksportues është i neglizhueshëm ose i ulët<sup>2</sup>, ose
- (b) ekziston në situatë tregu e vecantë në vendin eksportues, ose
- (c) shitjet vendase në vendin eksportues nuk janë në “rrjedhën e zakonshme të tregtisë” (p.sh., janë shitur nën kosto<sup>3</sup>, ose si shitje të lidhura, ose si shitje speciale).

Në këto kushte, cmimi i eksportit në fjalë krahasohet me

- (a) cmimin e eksportit të krahasueshëm të atij produkti në një vend të tretë nga vendi eksportues, ose
- (b) “vlerën e ndërtuar” e cila mbulon të gjitha kostot në vendin e origjinës plus një marzh fitimi<sup>4</sup>.

Ka një përjashtim në përcaktimin e vlerës normale për importet nga vendet të cilat kanë një monopol të tregtisë së tyre dhe ku të gjitha cmimet vendase përcaktohen nga shteti<sup>5</sup>. Ka klauzola të ndryshme në legjislacionet kombëtare për këtë përjashtim, si p.sh. krahasimin e cmimit të eksportit me:

---

<sup>2</sup> Volumi i shitjeve vendase zakonisht konsiderohet të ketë i pamjaftueshëm për qëllime krahasimi, nëse përbën më pak se 5% të volumit të totalit të eksportit të marrë në konsideratë, përveç në rastet kur evidenca tregojnë që një raport më i ulët mund të jetë i pranueshëm për një krahasim të përshtatshëm.

<sup>3</sup> Shitjet vendase në vendin eksportues mund të trajtohen si jo në “rrjedhën e zakonshme të tregtisë” për arsye të cmimit, kur këto shitje janë bërë brenda një periudhe kohe të zgjatur në sasi domethënëse dhe me cmime të cilat nuk sigurojnë mbulimin e të gjitha kostove Brenda një periudhe kohe të arsyshme. Shitje nën koston për njësi bëhen në sasi domethënëse nëse :

- cmimi mesatar i ponderuar në vendin vendin eksportues është më i ulët se kosto mesatare e ponderuar për njësi, ose
- volumi I shitjeve vendase nën koston për njësi përfaqëson 20% ose më shumë të volumit total të shitjeve vendase në tregun eksportues, dhe
- këto shitje janë bërë për një periudhë të zgjatur kohe (zakonisht 1 vit, minimumi 6 muaj).

<sup>4</sup> Kostot për njësi përfaqësojnë të gjitha kostot fikse dhe variable të prodhimit plus kostot administrative, të shitjes dhe të përgjithshme. Kostot dhe fitimi normalisht bazohen në të dhënat aktuale nga eksportuesi/prodhuesi në fjalë.

<sup>5</sup> Interpretim i Klauzolës Ad GATT 1994 Neni VI nga Aneksi I Paragrafi 1 Neni 2

- një vlerë të ndërtuar e cila mbulon të gjitha kostot (kosto e prodhimit plus kosto administrative, të shitjes dhe kosto fikse) plus një marzh fitimi në një vend të tretë analog, ose
- cmimin e eksportit të krahasueshëm të atij produktitë marrë nga një vend i tretë analog, ose
- cmimin e tregut vendas të atij produkti në një vend të tretë analog, ose
- cmimin e regut vendas të atij produkti në vendin importues.

Krahasimi i këtyre cmimeve bëhet në të njëjtin nivel tregtie, normalisht në nivelin e firmës eksportuese, dhe në raport me shitjet të bëra sa më shumë të jetë e mundur në të njëjtën kohë. Lejime bëhen për diferencat të cilat ndikojnë krahasueshmërinë në cmim, diferenca të tilla si:

- kushtet dhe termat e shitjes,
- tatimet
- nivelet e tregtisë
- sasisë, dhe
- karakteristikat fizike të produkteve.

Kthimi i monedhës për krahasimin e cmimit bëhet duke përdorur kursin e këmbimit në datën e shitjes. Për shitjet e bazuara në kontratat me afat, përdoret kursi i këmbimit i shitjes me afat.

Krahasimi mund të bëhet ose midis mesatares të ponderuar të vlerës normale të tëra transaksioneve gjatë periudhës së hetimit dhe cmimit mesatar të ponderuar gjatë të njëjtës periudhë, ose mbi një bazë transaksion për transaksion. Në qoftë se cmimet e eksportit të shitësit ndryshojnë shumë në varësi të blerësit, rajoneve ose periudhës së kohës në shqyrtim, mesatarja e ponderuar e vlerës normale mund të krahasohet me cmimet e transaksioneve individuale të eksportit.

Në qoftë se krahasimi rezulton në një marzh dumping prej më pak se 2% të cmimit të eksportit (i ashtëquajtur “marzhi minimum”), nuk mund të aplikohet asnjë masë anti-dumping për importet në fjalë.

Sic është përshkruar më lart, llogaritjet e marzhit dumping nuk janë të drejtpërdrejta dhe rezultatet parashikohen me vështirësi. Gjithsesi një monitorim i vazhdueshëm i cmimeve në vend dhe atyre të eksportit mund të ndihmojë eksportuesit për të vlerësuar mundësinë dhe madhësinë e marzheve dumping. Në qoftë se zbulimet janë pohuese dhe është e mundur që eksportet dumpet shkaktojnë ose kërcënojnë dëmtim për industrinë vendase të vendit importues, ndryshimet në cmimet e eksportit dhe/ose në cmimet në vend bëhen detyruese për një eksportues i cili dëshiron të shmangë riskun e të përballurit me taksa doganore anti-dumping.

Ulja e cmimit të ofruesit të tregut vendas është një opsion i kufizuar pasi, sic e pamë edhe më parë, shitja nën kosto në tregun vendas mund të konsiderohet si “jo në rrjedhën e zakonshme të tregtisë”.

Në këtë kontekst, ekziston një alternativë tjetër e cila mund të ndihmojë të eliminohet (ose ulet) marzhi dumping. Kjo përfshin përdorimin e diferencave në kosto që kanë ndodhur pas nivelit të firmës eksportuese dhe të cilat janë direkt të lidhura si me shitjet vendase edhe me eksportet. Është provuar që cmimi në tregun vendas është më i lartë se cmimi i eksportit, sepse disa nga kostot e shitjes, të përgjithshme dhe administrative që shkaktohen nga shitjet vendase nuk zbahohen për eksportet (ose janë më të ulta në rastin e eksporteve), rezultati do të jetë një diferencë më e vogël midis cmimeve të tregut dhe cmimeve të eksportit të firmës eksportuese, dhe për pasojë një marzh dumping më i ulët.

Këto ndryshime në kosto, mundet p.sh., të rezultojnë për afate pagese më të gjata për shitjet vendase krahasuar me eksportet, ose nga kostot e garancisë dhe të reklamës që ndodhin në shitjet vendase, por jo në eksportet, Këtu është e rëndësishme të theksohet që në mënyrë që këto diferenca të merren në konsideratë nga autoritetet në një hetim anti-dumping, duhet të dokumentohet lidhja direkte midis shitjeve dhe zërave relevant të koston.

### **2.3 Dëmtimi dhe Kërcënimi për Dëmtim**

Ajo cka e bën dumping “jo të drejtë” është “dëmtimi” që ai shkakton, ose kërcënon të shkaktojë ndaj industrisë vendase në vendin importues. “Dëmtimi” ekziston kur:

- ka një rritje domethënëse në volumin e eksporteve dumped, dhe
- importet dumped kanë shkaktuar ulje domethënëse në cmim, ose kanë parandaluar një rritje në cmim në vendin importues, dhe
- ka efekte negative aktuale dhe potenciale mbi shitjet, fitimin, outputin, pjesën e tregut, produktivitetin, kthimi mbi investimin, përdorimin e kapacitetit, fluksin e parasë, punësimin, pagat, rritja, mundësia për të rritur kapitalin ose investimet etj. nga prodhuesit vendas.

“Kërcënimi për dëmtim” ekziston në një situatë kur dumping që shkakton dëmtim prashikohet artë dhe dukshëm, d.m.th., kur ka:

- një rritje në volumin e impoteve dumped, dhe
- një kapacitet i disponueshëm lirshëm i mjaftueshëm i eksportuesit, ose një rritje thelbësore, e dukshme në këtë kapacitet, dhe

- një efekt potencial të rëndësishëm ulës apo shtypës mbi cmimet vendase për shkak të riskut të rritur të importeve dumped (duke marrë parasysh mundësinë e tregjeve të tjera për eksport për të thithur eksportet shtesë), dhe
- një rritje domethënëse në inventaret e produktit të hetuar.

Gjatë një hetimi anti-dumping, faktorët e mësipërm konsiderohen dhe analizohen në detaje nga autoritetet përkatëse. Gjithsesi evidencë e mjaftueshme e “marzhit të dumping” dhe të ekzistencës apo kërcënimit për dëmtim nuk është e mjaftueshme për të vendosur një taksë doganore anti-dumping. Midis të dyjave duhet të përcaktohet një lidhje shkakësore. Kjo do të thotë të përcaktosh nëse janë importet dumped që kanë shkaktuar apo kërcënojnë një dëmtim ndaj industrisë vendase, apo është shkaktuar nga dicka tjetër, si p.sh.:

- volumi dhe cmimet e importeve që nuk janë shitur me cmime dumping,
- një zvogëlim i kërkesës ose ndryshime në modelet e konsumit,
- praktikat shtrënguese të tregtisë, dhe konkurrenca midis prodhueseve të tjerë të huaj dhe/ose vendas, ose
- zhvillimet në teknologji, performanca në eksport dhe produktivitet i industrisë vendase.

Volumi i importeve dumped konsiderohet i neglizhueshëm-dhe nuk mund të vendosen taksa doganore anti-dumping (as nukmund të fillojnë hetimet)-nëse volumi i importeve dumped nga një vend i vecantë përbën më pak se 3% të importeve të atij produkti në vendin importues. Megjithatë, ky rregull nuk zbatohet nëse efektet e importeve dumped nga më shumë se një vend vlerësohen në mënyrë kumulative, dhe nëse vendet me pjesë individuale me më pak se 3% kolektivisht përbëjnë më shumë se 7% të importeve të atij produkti në vendin importues.

Në këtë kontekst, ka dy gjëra të rëndësishme që mund të bëjë një importues/eksportues:

- ***Të monitorojë rregullisht faktorët ekonomikë të sipërpërmendur dhe treguesit e tregut vendas të vendit importues. (A ka një prirje negative në tregun e vendit importues?)***

Kjo mund të ofrojë oportunitetin e vlerësimit të mundësisë për fillimin e një procedure anti-dumping dhe të ndihmojë firmën eksportuese/importuese të ndër marrë veprimet e nevojshme (si p.sh. të rrisë cmimin e eksportit) për të ulur rrezikun e një hetimi anti-dumping. Duke qenë më i familjarizuar me tregun e vendit importues, importuesit do ta kenë më të lehtë të bëjnë këtë monitorim sesa eksportuesit. Veprimet e nevojshme parandaluese mund të ndërmerren nga eksportuesi nëse parashikohet të fillojë një hetim anti-dumping.

Në këtë kuadër, një paralajmërim me vlerë për eksportuesit/importuesit është të jenë vigjilent kur ekonomia e vendit importues është në recension dhe niveli i kërkesës është në rënie. Në kushte të tilla, prodhuesit vendas janë më të prirur të jenë më të ndjeshëm ndaj humbjeve në shitje dhe në pjesën e tregut ndaj konkurrentëve të huaj se në kohë të tjera.

- ***Të analizojë dinamikat e prirjeve negative të tregut. (Pse ekziston kjo prirje negative?)***

Kjo analizë mund të jetë e dobishme për të gjetur arsye përveç importeve për prirjet negative që ndikojnë industrinë vendase. Nëse këto arsye ekzistojnë, ato mund të jenë një argument i fuqishëm për eksportuesit/importuesit kur mbrojnë interesat e tyre në një veprim anti-dumping. Megjithatë, ato mund të influencojnë vendimin final të autoriteteve hetuese vetëm nëse shifrat dhe argumentat e prezantuar nga eksportuesit dhe importuesit janë të sakta dhe të bazuara në burime objektive të informacionit.

### 3. Hetimet Antidumping

#### 3.1 Fillimi i një Hetimi Anti-Dumping

Në hetimet anti-dumping, autoritetet vlerësojnë ekzistencën dhe madhësinë e dumping dhe dëmtimin (ose rrezikun për dëmtim) dhe lidhjen shkakësore midis të dyjave. Nëse është e nevojshme ato marrin masa për të shmangur ose parandaluar dumping duke përshtatur masa anti-dumping.

Hetimet anti-dumping normalisht fillojnë në bazë të një aplikimi të shkruar nga, ose në emër të industrisë vendase. Megjithatë autoritetet kompetente për të ndërmarrë hetime anti-dumping mundet gjithashtu të fillojnë procedurat pa marrë një aplikim të tillë. Në të dyja rastet, një kusht i nevojshëm për fillim është ekzistenca e një evidence të mjaftueshme për dumping dhe për dëmtim dhe një lidhje shkakësore midis të dyjave. Aplikimi duhet të përmbajë informacion-që në mënyrë të arsyeshme është i disponueshëm nga aplikanti-si p.sh.:

- Identiteti i aplikantit dhe volumi dhe vlera e prodhimit vendas,
- Një përshkrimi produktit dumped dhe emri i vendit të origjinës/eksportit, emrat e eksportuesve/importuesve/prodhueseve të huaj të njohur, vlera normale dhe cmimet e eksportit të produktit të pretenduar si dumped, dhe
- Volumi i importeve të pretenduara dumped dhe efekti i këtyre importeve në cmimin e atij produkti në tregun vendas dhe mbi industrinë vendase.

Një aplikim konsiderohet tt jetë bërë nga, ose në emër të industrisë vendase nëse prodhimi total i prodhuesve vendas që mbështetin aplikimin është:

- Më i madh se prodhimi total i prodhuesve vendas që e kundërshtojnë atë, dhe
- Jo më pak se 25% e prodhimit total të industrisë vendase.

Nuk lejohet publikimi i aplikimit nga autoritetet përvec në rastet kur shtë marrë vendimi për të filluar një hetim anti-dumping. Lajmërimi për qeverinë e vendit eksportues duhet të bëhet para procedurave të fillimit të hetimit.

Sipas kësaj procedure, eksportuesit dhe importuesit e produktit të pretenduar dumped, nuk kanë shumë shanse për të mbrojtur interesat e tyre para fillimit të hetimit anti-dumping, përvec rastit kur ankesat për importet në fjalë janë bërë publike nga aplikanti. Nëse është e njohur që është bërë një aplikim i tillë, ose që ka mundësi të bëhet, mund të jetë e këshillueshme për eksportuesit dhe importuesit e produktit të

pretenduar dumped të zhvillojnë kundër argumenta mbi pretendimet për dumping, dmtim dhe shkakësi, dhe t'i bëjnë ato të njohura në publik, në mënyrë që të shmangin hetimin nëse arsyet për të provohen të jenë të pabazuara.

Nëse autoritetet gjejnë evidencë të mjaftueshme për të filluar një hetim anti-dumping, atëherë duhet të bëhet një njoftim publik, ose t'i ofrohet publikut një raport i cili ofron informacion për fillimin e hetimit. Njoftimi publik dhe raporti duhet të përfshijnë informacion të tillë si:

- Emri i vendit/vendeve eksportuese dhe produkti i përfshirë;
- Data e fillimit të hetimit;
- Bazat mbi të cilat pretendohet dumping në aplikim;
- Përmbledhje e faktorëve mbi të cilat bazohet pretendimi për dëmtim;
- Adresa ku duhet të drejtohen përfaqësimet e palëve të interesuara;
- Koha limit që u lejohet palëve të interesuara (p.sh. eksportuesit, importuesit, prodhuesit e huaj dhe vendas, dhe shoqatat e lidhura) për të bërë të njohura pikëpamjet e tyre.

### 3.2 Procedura e Hetimit

Megjithëse ka ndryshime nga njëri vend në tjetrin në procedurat për hetimet anti-dumping, procedimet zakonisht përfshijnë tre etapa kryesore të cilat mbivendosen në kohë:

- Mbledhja e informacionit (p.sh. nga pyetësorët, takimet me palët e interesuara, hetimet në vend)
- Vlerësimi i informacionit (p.sh. përcaktimet për dumping, dëmtim dhe shkakësi midis të dyjave); dhe
- Zbatimi i masave të përkohshme, taksat doganore anti-dumping ose ndërmarrjet në cmim, ose përfundimi I procedimeve pa ndonjë masë të tillë.

Sipas rregullave të OBT, të gjitha këto procedime zakonisht duhet të mbyllen brenda një viti, dhe maksimumi 18 muaj pas fillimit të tyre. Gjatë kësaj periudhe nuk duhet të pengohen procedurat përkatëse për sqarimet doganore.

Në një hetim anti dumping, importuesit dhe eksportuesit e produktit të pretenduar dumped pritet të:

- Paraqesin të tërë informacionine kërkuar nga autoritetet, brenda kufijve kohorë të specifikuar në njoftimin publik (ose raport);
- Të ofrojnë një përblehje jo konfidenciale të informacionit konfidencial të ofruar qutoriteteve (nëse kjo është e pamundur duhet të jepen arsyet);

- Të lejojnë autoritetet të verifikojnë saktësinë e informacionit të ofruar dhe të marrin detaje të metejshme me anë të hetimeve në vend në firmë, dhe tu ofrojnë autoriteteve të gjithë informacionin dhe dokumentat e kërkuara gjatë këtyre vizitave (një hetim në vend i eksportuesit mund të ndërmerret vetëm, nëse firma në fjalë bie dakort dhe qeveria e vendit eksportues nuk e kundërshton atë).

Në një hetim anti-dumping, importuesit (IM) dhe eksportuesit (EX) kanë të drejtat e mëposhtme:

- T'u jepet të paktën 30 ditë kohë t'u përgjigjen pyetësorëve të dërguara nga autoritetet (EX);
- Të kërkojnë një zgjatje deri në 30 ditë për t'u përgjigjur pyetësorëve (EX);
- Të kërkojnë tekstin e plotë të aplikimit të shkruar për nisjen e hetimit anti-dumping (në rastin e një numri të vogël eksportuesish, teksti ofrohet pa patur nevojë për kërkues. Gjithësesi, nëse numri i eksportuesve në fjalë është vecanërisht i madh, teksti i ofrohet vetëm qeverisë së vendit eksportues ose shoqatës tregtare përkatëse) (IM&EX);
- T'u bëjnë të njohur pikëpamjet e tyre autoriteteve (IM&EX);
- Të kërkojnë mbrojtje të informacionit të tyre konfidencial (shiko më poshtë) (IM&EX);
- Të kërkojnë të kenë mundësinë në kohë të shohin të gjithë informacionin jo konfidencial të ofruar nga palët e tjera të interesuara (IM&EX);
- T'u ofrojnë informacion gojor autoriteteve (i cili duhte më pas të riprodhohet i shkruar) (IM&EX);
- Të kërkojnë të takohen me palët e tjera me interesa të kundërta (IM&EX);
- T'u ofrojnë informacion autoriteteve, megjithëse ato vetë nuk janë përfshirë në një hetim të kufizuar (shiko më poshtë) (EX);
- Të informohen rreth fakteve thelbësore që formojnë vendimin final nga autoritetet në fund të hetimit anti-dumping (kjo dhënie informacioni duhet të realizohet në kohën e mjaftueshme për palët që ato të mund të mbrojnë interesat e tyre) (IM&EX);
- T'u jepet mundësia të komentojnë mbi zbatimin prapaveprues të taksave doganore anti-dumping (IM) (shiko seksioni 3.3.2);
- Të rimbursohen për depozitat në *cash* të bëra (si masë e përkohshme) para përcaktimit të ekzistencës së kërcënimit për dëmtim ose vonimit të vendosjes së industrisë vendase (IM) (shiko seksioni 3.3.2);
- Të rimbursohen për diferencën midis taksave doganore anti-dumping përfundimtare dhe të përkohshme, nëse taksa doganore anti-dumping përfundimtare është më e ulët se taksa doganore e përkohshme (IM) (shiko seksioni 3.3.2);
- Të rimbursohen për cdo depozitë në *cash* të bërë si masë e përkohshme nëse përcaktimi përfundimtar është negativ (IM) (shiko seksioni 3.3.2);

- Të kenë opsinin e pranimit apo të kundërshtimit të ndërmarrjes në cmim të sugjeruar nga autoritetet (EX) (shiko seksioni 3.3.3);
- Të informohen nga autoritetet për arsyet e mospranimit të tyre nëse ofrohet ndonjë ndërmarrje në cmim (EX) (shiko seksioni 3.3.3);
- Të kërkojnë një zgjatje të zbatimit të masave të përkohshme, nëse një eksportues ose një grup eksportuesish përfaqësojnë një përqindje domethënëse të tregtisë në fjalë EX) (shiko seksioni 3.3.3);
- Të kërkojnë një rishikim të përcaktimit të një marzhi dumping individual, nëse eksportuesi nuk po eksportonte në vendin importues para vendosjes së masave anti-dumping kundër eksportuesve të tjerë (EX) (shiko seksioni 3.3.2).

Konfidencialiteti i informacionit të dhënë autoriteteve është një aspekt shumë i rëndësishëm i hetimeve anti-dumping. Informacioni konsiderohet “konfidencial nga natyra” nëse dhënia e tij:

- I jep konkurentit një avantazh konkurrues të rëndësishëm; ose
- Ndikon në të kundërt ofruesin e informacionit ose burimin e informacionit.

Informacioni mundet gjithashtu të konsiderohet si konfidencial me kërkesën e ofruesit të informacionit, dhe me pranimin e autoriteteve mbi nevojën e trajtimit konfidencial. Nëse është konfidencial, ky informacion nuk mund të jepet pa leje të vecantë të palës që e ofron atë.

Nga ana tjetër, ofruesit e informacionit konfidencial kërkohet të ofrojnë përmbledhje jo konfidenciale të këtij informacioni. Kjo përmbledhje duhet të ketë detaje të mjaftueshme në mënyrë që të lejojë një kuptim të arsyeshëm të përmbajtjes së informacionit konfidencial. Si përjashtim, nëse ofruesi i informacionit e konsideron informacionin jo të përshtatshëm për përmbledhje, ai duhet të arsyet për këtë. Nëse autoritetet zbulojnë që:

- Kërkesa për konfidencialitet nuk është e justifikueshme dhe
- Ofruesi i informacionit nuk është i gatshëm të bëjë publik informacionin ose të autorizojë dhënien e informacionit në një formë përmbledhëse ose të përgjithshme,

atëherë autoritetet mund të mos e marrin parasysh këtë informacionin, përveç se kur janë të sigurt që informacioni është korrekt.

Nëse një palë refuzon të ketë akses, ose refuzon të ofrojë informacionin e nevojshëm brenda një periudhe kohe të arsyeshme, ose nëse pengon hetimin në mënyrë domethënëse, autoritetet mund të bëjnë përcaktimin në bazë të të dhënave të disponueshme. Në këtë rast, informacioni i përfshirë në aplikimin për fillimin e hetimit nga industria vendase ose informacioni nga burimet dytësore (p.sh. listat e

cmimeve të publikuara, statistikat zyrtare mbi importet) mund të përdoren dhe kjo mund të çojë në rezultate më pak të favorshme për palën sesa nëse pala do të bashkëpunonte. Palëve gjithashtu mund t'u kërkohej të ofrojnë informacion në mënyra (p.sh. disketa kompjuteri) apo gjuhë kompjuteri specifike. Nëse ato nuk e kanë të mundur të ofrojnë informacionin në mënyrën e kërkuar, ato duhet të informojnë autoritetet për arsyet.

Në një hetim anti-dumping, autoritetet normalisht përcaktojnë një marzh dumping individual për secilin nga eksportuesit apo prodhuesit e produktit të njohur në hetim. Megjithatë, nëse numri i eksportuesve, prodhuesve, importuesve ose llojet e produkteve të përfshira është i madh, autoritetet mund të kufizojnë ekzaminimin e tyre në një numër të arsyeshëm të palëve të interesuar ose produkteve, ose në përqindjen më të madhe të eksportit nga vendi eksportues, që mund të hetohet në mënyrë të arsyeshme. Nëse ekzaminimi kufizohet në këtë mënyrë, zgjedhja e seleksionuar e palëve dhe produkteve duhet të jetë statistiksht përfaqësuese dhe e bërë në konsultime dhe me aprovimin e eksportuesve, importuesve apo prodhuesve të përfshirë. Një eksportues ose prodhues që nuk është zgjedhur fillimisht mund të ofrojë vullnetarisht informacionin e nevojshëm në kohë në mënyrë që të konsiderohet në përfundimet. Ky informacion duhet të konsiderohet gjithashtu nga autoritetet, përveç në rastet kur numri i eksportuesve është aq i madh sa që ekzaminimet individuale do të ishin një barrë për to dhe do t'i pengonte në përfundimin në kohë të procedurave.

Nën këto rregulla, nëse një eksportues ose importues nuk do të përballet me masa anti-dumping të përcaktuara në bazë të informacionit të ofruar nga burime të tjera (p.sh. importues, eksportues të tjerë ose prodhues vendas të vendit importues), strategjia më e mirë është të bashkëpunojë me autoritetet. Kjo përgjithësisht përfshin:

- Dhënia atyre gjithë informacioni i kërkuar në kohë dhe formën e kërkuar, dhe lejimi i tyre të bëjnë hetime në vend; dhe
- Bërja e ditur autoriteteve e opinioneve të tyre.

Kjo mënyrë jo vetëm ndihmon eksportuesit dhe importuesit e të ushtrojnë kontroll më të madh mbi bazën e informacionit të përdorur në përcaktimet për importet/eksportet e tyre, por u lejon atyre të jenë në dijeni të informacionit të ofruar nga palët e tjera dhe të luajnë një rol aktiv në procedimet.

### **3.3 Zbatimi i Masave Anti-Dumping**

#### (i) Masat e Përkohshme

Nëse përcaktimet paraprake të autoriteteve mbi ekzistencën e dumping, dëmtimit (ose kërcënimit për dëmtim) dhe të shkakësisë midis të dyjave janë afirmative, atëherë mund të zbatohen masa të përkohshme me qëllim për të parandaluar dëmtimin të shkaktuar gjatë rrjedhës së hetimit.

Këto masa mund të jenë në formën e:

- Taksë doganore e përkohshme
- Depositë sigurie (cash ose obligacione) e barabartë me shumën e vlerësuar të taksës doganore anti-dumping të përkohshme; ose
- Fshehje e vlerësimit (pezullim i likuidimit) sipas së cilës specifikohet një taksë doganore e llogaritur e cila do të përcaktohet përfundimisht gjatë hetimit.

Masat e përkohshme nuk mund të zbatohen më herët se 60 ditë pas datës së fillimit të hetimit. Zbatimi i masave të përkohshme është i kufizuar në një zgjatje kohore maksimum prej 4 muajsh, por nëse bëhet kërkesë nga eksportuesit të cilët përfaqësojnë një përqindje domethënëse të tregtisë së përfshirë në këtë periudhë, atëherë mund të shtyhet deri në 6 muaj. Nëse autoritetet vlerësojnë që një taksë doganore më e ulët se marzhi i dumping do të ishte e mjaftueshme për të hequr dëmtimin, atëherë kjo periudhë mund të jetë respektivisht 6 dhe 9 muaj.

Duke qenë se skadimi i masave të përkohshme shpesh përputhet me përfundimin e procedimeve, do të ishte e dobishme për eksportuesit e produktit në fjalë të kërkonin një zgjatje të masave të përkohshme për të patur kohë shtesë për:

- Vlerësuar përfundimet e nxjerra nga autoritetet mbi të cilat janë bazuar masat e përkohshme;
- T'u bëjnë të njohur pikëpamjet e tyre autoriteteve mbi këto përfundime; ose
- Të vendosin nëse do të ndërmarrin ose jo një sipërmarrje në cmim

#### (ii) Taksat Doganore Anti-Dumping

Praktika e vendosjes dhe e mbledhjes mbi taksat doganore përfundimtare anti-dumping ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Këto diferenca kryesisht rrjedhin nga zgjedhja e bërë midis përdorimit të vlerave normale aktuale apo të kaluara si baza për përcaktimin e marzhit anti-dumping.

Nga njëra anë, ka disa vende që përcaktojnë marzhet anti-dumping duke krahasuar cmimin e eksportit dhe vlerën normale të realizuar para fillimit të hetimeve anti-dumping, dhe të vendosin taksa doganore anti-dumping të fikse mbi të gjitha importet e ardhshme (p.sh., BE, Turqi). Nga ana tjetër, ka vende në të cilat cmimet e eksportit krahasohen me vlerën normale aktuale (të përcaktuara si rezultat i rishikimeve periodike) dhe taksat doganore anti-dumping përcaktohen transaksion për

transaksion (p.sh. SHBA). Në mes, ka vende që krahasojnë një vlerë normale “të ardhshme” të bazuar në të dhëna të së kaluarës me cmimet aktuale të eksportit, dhe aplikojnë taksa doganore anti-dumping transaksion për transaksion (p.sh., Kanada, Australi).

Nëse taksat doganore anti-dumping zbatohen në një bazë transaksion për transaksion, importuesit i paguajnë këto taksa doganore vetën nëse cmimi i eksportit është më i vogël se vlera normale aktuale apo e ardhshme. Kështu, kjo mënyrë e vlerësimit të taksës doganore u jep mundësinë eksportuesve dhe importuesve për të shmangur detyrimin për të paguar taksën doganore “që duhej të paguhej”, nëse cmimet e eksportit janë rritur të paktën në nivelin e vlerës normale. Megjithatë, nëse taksat doganore anti-dumping janë fiksuar (mbi një bazë *ad valorem* ose specifike), atëherë importuesit duhet të paguajnë taksën doganore anti-dumping edhe nëse cmimet e eksportit janë rritur në nivelin e vlerës normale, por kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim.<sup>6</sup>

Në disa vende, madhësia e taksës doganore anti-dumping vendoset gjithmonë e barabartë me marzhin dumping (p.sh. SHBA, Kanada) ndërkohë, në vende të tjera, është e barabartë me shumën e cila është e vendosur për të hequr dëmtimin ose e barabartë me marzhin dumping, bazuar se cila është më e vogël (i ashtëquajtur “Rregulli i Taksës Doganore me të Vogël”, p.sh., BE, Turqi, Australi)<sup>7</sup>. Në asnjë rast, madhësia e taksës doganore anti-dumping të vendosur nuk mund të jetë më e madhe se marzhi i dumping. Në rastet kur zbulohet që taksat doganore të paguara aktualisht janë më të mëdha se marzhi dumping ose taksat doganore të vlerësuara përfundimisht (të rishikuara), importuesit mund të rimbursohen për tepicën e paguar në taksa doganore.

Nëse autoritetet e kanë kufizuar ekzaminimin e tyre vetën në një grup të zgjedhur eksportuesish ose importuesish, taksa doganore e zbatuar mbi importet, eksportuesve ose prodhuesit të papërfshirë në ekzaminim nuk mund të kalojë:

- Mesataren e ponderuar të marzhit dumping të vendosur bazuar në eksportuesit apo prodhuesit e zgjedhur; ose
- Kur vlera normale është një vlerë e ardhme e bazuar në të dhëna të kaluara, diferencën midis mesatares së ponderuar të vlerave normale të eksportuesve

<sup>6</sup> Këto rritje në cmim mundet, megjithatë të cojnë në përfundim taksave doganore anti-dumping. Kjo ndodh vetëm nëse një rishikim i cmimeve të eksportit (të rritura) dhe i vlerës normale përcakton që skadimi i taksës doganore not do të kishte të ngjarë të conte në vazhdim apo rindodhje të dumping apo dëmtimit.

<sup>7</sup> Për të përcaktuar shumën e taksave doganore anti-dumping të nevojshme për të hequr dëmtimin, këto taksa doganore mund të vendosen duke iu referuar “cmimeve shënjestër” ose “marzheve FOB jo-dëmtues (JDFOB)” të cilat tregojnë nivelin e cmimit të eksportit në të cilin nuk i shkaktohet dëm industrisë vendase.

ose të prodhuesve dhe cmimeve të eksportit të eksportuesve apo prodhuesve që nuk janë ekzaminuar individualisht<sup>8</sup>.

Nëse numri i eksportuesve dhe i prodhuesve nuk është i madh, atëherë vendosen taksa doganore anti-dumping individuale për secilin nga eksportuesit dhe prodhuesit në fjalë. Në të kundërt, të njëjtat taksa doganore anti-dumping mund të vendosen kolektivisht mbi:

- Të gjitha importet dumped të produktit që vijnë nga vendi eksportues; ose
- Importet dumped të pjesës së mbetur të eksportuesve dhe të prodhuesve në vendin eksportues për të cilat taksat doganore anti-dumping nuk janë vendosur individualisht.

Mund të ketë eksportues dhe prodhues të cilët nuk eksportuan produktin në fjalë në vendin importues gjatë periudhës së hetimit, por kanë filluar të eksportojnë atë pas vendosjes së taksës doganore anti-dumping. Nëse këto eksportues dhe prodhues të rinj –të ashtëquajturit “të ardhurit e rinj”- mund të tregojnë që ato nuk janë të lidhur me asnjë nga eksportuesit apo prodhuesit e vendit eksportues që janë objekt të taksave doganore anti-dumping mbi produktin, ato mund të kërkojnë një rishikim për të përcaktuar marzhet individuale të dumping për ta. Ndërkohë që ndërmerret ky rishikim, nuk mund të vendoset asnjë taksë doganore anti-dumping mbi importet e këtyre eksportuesve dhe prodhuesve të rinj. Megjithatë, autoritetet mund të fshehin vlerësimin dhe/ose të kërkojnë garanci që në rastet që ky rishikim rezulton në përcaktim të dumping për këto prodhues të rinj, taksat doganore anti-dumping mund të kenë fuqi prapavepruese në datën e fillimit të rishikimit.

Është përgjegjësi e importuesve të veprojnë në përputhje me masat e përkohshme dhe për pagesën. Këto janë të zbatueshme normalisht për produktet të cilat hyjnë në vend për konsum pas datës së vendosjes së këtyre masave. Megjithatë, këto masa mund të kenë fuqi prapavepruese në situatat e mëposhtme:

- (a) Nëse, pas zbatimit të masave të përkohshme, përcaktimi përfundimtar i dëmtimit është afirmativ, atëherë taksat doganore anti-dumping mund të vendosen me fuqi prapavepruese për periudhën gjatë së cilës janë zbatuar masat e përkohshme.
- (b) Nëse, pas zbatimit të masave të përkohshme, përcaktimi përfundimtar vendos që eziston kërcënimi për dëmtim dhe që dëmtim actual mund të kishte ndodhur në mungesë së këtyre masave të përkohshme, atëherë taksat doganore anti-dumping mund të zbatohen me fuqi prapavepruese për priudhën gjatë së cilës janë zbatuar masat e përkohshme.

---

<sup>8</sup> Cdo marzh zero dhe *de minimis* dhe marzhet e vendosura mbi bazën e informacionit më të mirë të disponueshëm (nëse eksportuesit/prodhuesit nuk kanë ofruar informacionin e nevojshëm) nuk merren në konsideratë në llogaritjen e mesatares së ponderuar të marzhit dumping.

- (c) Nëse është përcaktuar që ekziston një histori e dumping që ka shkaktuar dëmtim, ose që importuesi ishte (ose duhej të ishte) në dijeni që eksportuesi po praktikonte dumping dhe që ky dumping do të mund të shkaktonte dëmtim, dhe nëse dëmtimi shkaktohet nga importe massive dumped në një kohë relativisht të shkurtër para fillimit të zbatimit të masës së përkohshme, atëherë taksat doganore anti-dumping mund të zbatohen me fuqi prapavepruese për deri në 90 ditë para fillimit të këtyre masave të përkohshme. (Në një rast të tillë, autoritetet duhet t'u japin mundësi importuesve për të komentuar.)

Megjithatë, asnjë taksë doganore nuk mund të zbatohet me fuqi prapavepruese mbi produktet që kanë hyrë për konsum para datës së fillimit të hetimit anti-dumping.

Nëse është përcaktuar që ekziston kërcënimi për dëmtim ose vonim material në vendosjen e një industrie pas zbatimit të taksave doganore të përkohshme, taksa doganore e përhershme mund të vendoset vetëm duke filluar nga data e këtij përcaktimi. Cdo depozitë më cash e bërë para kësaj kohe rimburohet dhe cdo detyrim hiqet.

Nëse taksa doganore anti-dumping përfundimtare është më e madhe se taksa doganore e përkohshme e paguar ose për t'u paguar, atëherë diferenca nuk mblihdhet. Nëse taksa doganore përfundimtare është më e ulët, diferenca i rimburohet importuesit mbi taksën doganore të rilogaritur.

Nëse përcaktimi përfundimtar për dumping, dëmtim, ose shkakësinë midis të dyjave është negative, atëherë cdo depozitë në cash e bërë gjatë periudhës së zbatimit të masës së përkohshme i rimburohet importuesit dhe cdo detyrim hiqet.

### (iii) Sipërmarrjet në Cmim

Pas përcaktimit paraprak pozitiv të dumping dhe të dëmtimit dhe të lidhjes shkakësore midis të dyjave, eksportuesit e produktit në fjalë mundet vullnetarisht të ndërmarrin një rritje të cmimeve të tyre të eksportit ose të reshtin eksportet me cmime dumped. Kjo mund të cojë në ndërprerjen ose përfundimin e këtyre procedimeve. Rritjet në cmim në këto sipërmarrje mund të jenë në një nivel i cili është i nevojshëm të për të hequr dëmtimin, por jo më i madh se marzhi i dumping.

Këto sipërmarrje në cmim të ofruara nuk ka nevojë të pranohen nga autoritetet nëse atyre i duket pranimi i tyre jo o dobishëm për arsye të ndryshme, si p.sh.numri i madh i eksportuesve aktualë dhe potencialë, apo arsye politike të përgjithshme. Në një rast të tillë, autoritetet duhet të ofrojnë arsyet përkatëse për këtë refuzim dhe t'u japin atyre mundësinë për të bërë komente mbi këtë.

Pasi pranohet një sipërmarrje, hetimi megjithatë mund të vazhdojë nëse eksportuesit e dëshirojnë apo autoritetet e vendosin. Nëse në fund, përcaktimi i dumping është negativ, sipërmarrjet automatikisht përfundojnë, përveç në raste kur arsyeja për këtë përcaktim është vetë sipërmarrja. Në këtë rast, ose nëse përcaktimet e dumping dhe dëmtim janë afirmative, atëherë sipërmarrjet mbahen.

Sipërmarrjet në cmim mund të sugjerohen gjithashtu nga autoritetet, por eksportuesit nuk mund të detyrohen t'i pranojnë ato. Nëse eksportuesit nuk e pranojnë këtë ftesë ose nuk ofrojnë ndonjë sipërmarrje në cmim, kjo nuk mund të paragjykojë konsideratat për këtë rast. Megjithatë, në kushte të tilla autoritetet mund të përcaktojnë që një kërcënim për dëmtim është më i mundur të ekzistojë nëse importet dumped vazhdojnë, dhe kjo mund të çojë në zbatim me fuqi prapavepruese të taksave doganore anti-dumping.

Eksportuesve mund t'u kërkohet të ofrojnë informacion periodik për të treguar përputhjen e tyre me sipërmarrjet dhe mund t'u kërkohet të lejijnë verifikimin e të dhënave përkatëse. Nëse sipërmarrjet dhunohen, autoritetet mund të zbatojnë menjëherë masat e përkohshme duke përdorur informacionin më të mirë të disponueshëm, dhe për pasojë të vendosin taksa doganore anti-dumping me fuqi prapavepreuese deri 90 ditë para zbatimit të këtyre masave të përkohshme.

Një sipërmarrje në cmim mund të jetë me avantazh për një eksportues nëse alternativa është një taksë doganore anti-dumping e fiksuar pavarësisht nga cmimi i eksportit. Në këtë rast, duke sipërmarrë një një rritje në cmim në nivelin e vlerës normale, eksportuesi mban shumën që në rast të kundër do të paguhej nga importuesi si taksë doganore anti-dumping.

Megjithatë, nëse eksportuesi planifikon (ose pret) që të ulë cmimet si në vend edhe në tregjet e eksportit për shkak të arsyeve të ndryshme si p.sh ulja e kostos, atëherë një sipërmarrje në cmim do të ishte një zgjidhje shumë e ngurtë duke qenë se pengon rritje potenciale në pjesën e tregut në tregun e vendit importues. Kjo mungesë fleksibiliteti mund të sjellë disavantazhe për eksportuesit e vendeve ku zhvlerësimi i monedhës locale promovon eksportet. Kjo ndodh sepse sipërmarrjet në cmim pengojnë uljet e cmimëve të eksportit në të ardhmen të cilat mund të rezultojnë nga zhvlerësime të mëtejshme të monedhës vendase.

#### (iv) Njoftimi Publik i Masave Anti-Dumping dhe Mbyllja e Hetimeve

Si dhe në rastin e fillimit të hetimeve anti-dumping, duhet të jepet njoftim publik (ose të publikohet një raport) nëse hetimi rezulton në:

- Vendosje të masave të përkohshme ose të përhershme;

- 
- Vendim për të pranuar një sipërmarrje në cmim;
  - Përfundimin e një takes doganore të përhershme (shiko seksioni 4.1);
  - Përfundimin e një sipërmarrjeje në cmim (shiko seksioni 4.1); ose
  - Vendim në lidhje me zbatimin me fuqi prapavepruese të taksave doganore

Të gjitha këro njoftime dhe raporte duhet të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës për faktet, ligjet dhe arsyet duke patur kujdes në kërkesë për të mbrojtur informacionin konfidencial.

Njoftimet (ose raportet) në lidhje me vendosjen e masave të përkohshme dhe të përhershme dhe sipërmarrjeve në cmim duhet të përmbajnë në vecanti:

- Emrat e ofruesve ose, kur kjo nuk është e mundur, e vendeve ofruese të përfshira;
- Një përshkrim të mjaftueshëm të produktit për qëllimet e doganës;
- Marzhet e dumping të vendosura dhe shpjegim të plotë të arsyeve për metodologjinë e përdorur në vendosjen dhe në krahasimin e cmimit të eksportit me vlerën normale;
- Konsideratat në lidhje me përcaktimin e dëmtimit; dhe
- Arsyet kryesore që çuan në atë përcaktim.

Cdo njoftim publik (ose raport) në lidhje me vendosjen e një takase doganore përfundimtare ose pranimin e një sipërmarrjeje në cmim duhet të tregojë arsyet për pranimin ose refuzimin e argumentave apo pretendimeve përkatëse të bëra nga eksportuesit dhe importuesit. Nëse eksportuesit ose prodhuesit, të papërfshirë në një hetim të kufizuar, ofrojnë vullnetarisht informacion, bazat për cdo vendim për ta konsideruar apo jo këtë informacion duhet të specifikohen në njoftim (ose raport) gjithashtu.

---

## 4. Veprimet qe pasojne mbylljen e hetimeve Anti-Dumping

### 4.1 Zgjatja dhe Rishikimi i Masave Anti-Dumping

Masat anti-dumping qëndrojnë në fuqi për sa kohë është e nevojshme për të kundërvepruar mbi cdo dumping që po shkakton dëmtim. Gjithsesi, këto masa mund të rishikohen me inisiativën e vetë autoriteteve ose me kërkesë të cdo pale të interesuar, e cila duhet të ofrojë informacion për të bazuar nevojën për rishikim. Megjithatë, rishikimi mund të kërkohet vetëm pas një periudhe të arsyeshme kohe pas vendosjes së taskës doganore përfundimtare anti-dumping. Rishikimi i masës në fjalë përfshin një ekzaminim të:

- (a) nëse vendosja e vazhduar e taksës është e nevojshme për të mënjanuar dumping dhe/ose
- (b) nëse dëmtimi do të kishte të ngjarë të vazhdonte ose të rindodhte nëse taksa doganore do të hiqej apo do të ndryshohej.

Si rezultat i një rishikimi të tillë, një masë anti-dumping mund të mbahet, përfundojë, rritet ose ulet nga autoritetet.

Një masë anti-dumping do të përfundojë automatikisht pas pesë vitesh nga data e zbatimit të masës përfundimtare anti-dumping (ose nga data e rishikimit më të fundit i cili mbulonte si dumping edhe dëmtimin), përveç nëse autoritetet përcaktojnë, në një rishikim të bërë para kësaj date, nevojën për vazhdim të masës ose për zbatim të masave të reja. Taksa doganore mund të qëndrojë në fuqi deri në rezultatin e një rishikimi të tillë.

Të gjitha përfundimet, procedurat dhe kërkesat për njoftime që zbatohen gjatë hetimeve anti-dumping mund të zbatohen gjithashtu gjatë cdo rishikimi të masave rezultuese anti-dumping. Një rishikim ikëtyre masave normalisht duhet të përfundohet jo më vonë se 12 muaj pas datës së fillimit të këtij rishikimi.

### 4.2 Rishikimi Juridik

Të gjitha veprimet administrative që lidhen me përfundimet finale në hetimet anti-dumping, dhe në rishikimin e këtyre përfundimeve, mund të rishikohen në gjykatat përkatëse juridike, arbitrare apo administrative të vendit importues. Sipas rregullave të OBT-së, këto gjykata dhe procedurat e rishikimeve të tilla juridike duhet të jenë të pavarura nga autoritetet përgjegjëse për kryerjen e procedimeve. Këto rishikime juridike mund t'u japin mundësinë importuesve dhe eksportuesve – si dhe palëve të tjera të interesuara- të vënë në dyshim p.sh., nëse përfundimet e fundit afirmative apo negative dhe vendosja e masave mbështetur në evidencë bazë dhe në të

dhëna në përputhje me ligjin, dhe nëse ka patur ndonjë vendim arbitrar ose të gabuar apo abuzim të lirisë së veprimit nga autoritetet.

#### **4.3 Konsultimet Ndërqeveritare dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve mbi Veprimet Anti-Dumping**

Eshtë e mundur për cdo vend të prekur, anëtar të OBT-së, të kërkojë konsultime për veprimet anti-dumping të një vendi tjetër anëtar importues. Nëse këto konsultime dështojnë në arritjen e një zgjidhjeje të rënë dakort bashkarisht dhe nëse vendi importues vendos të vendosë taksa anti-dumping përfundimtare ose të pranojë sipërmarrjet në cmim, atëherë anëtari kërkues mund t'ia drejtojë çështjen “Trupit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve” të OBT-së, ku ngrihet një panel për të shqyrtuar çështjen në fjalë. Nëse ky panel vendos që autoritetet e vendit anëtar importues i kanë vendosur faktet saktë dhe vlerësimi i tyre ka qenë i paanshëm dhe objektiv, atëherë vlerësimi nuk mund të ndryshohet, edhe nëse paneli ka arritur një konkluzion të ndryshëm. Nëse paneli vendos që masat në fjalë nuk janë në përputhje me rregullat përkatëse të OBT-së, ai i rekomandon vendit importues të të sjellë masën në konform me Marrëveshjen. Nëse rekomandimet e bëra nga paneli ose më vonë nga “Trupi Apeluar” nuk janë zbatuar nga vendi importues brenda një periudhe të arsyeshme kohe, vendi eksportues mund të pezullojë disa koncesione ose detyrime të tjera sipas Marrëveshjeve të OBT-së ndaj vendit importues<sup>9</sup>.

---

<sup>9</sup> GATT 1994 Aneksi 2: Të kuptuarit e Rregullave dhe Procedurave që Drejtojnë Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve